



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:112624
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05715907

Ac.nr.7053/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci, anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit B.H.G., nga fshati N..., Komuna Kaçanik të cilin me autorizim e përfaqëson M.K.B., avokat me seli në Komuna Kaçanik, ndaj të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me seli në Komuna Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson Naime Abazi, avokate shtetërore lidhur me kompensimin e dëmit-humbje e vlerës së pasurisë së paluajtshme të mbetur jashtë pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik CN.nr.62/17 datë 23.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor-Qeveria e Republikës së Kosovës, me seli në Komuna Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik CN.nr.62/17 datë 23.07.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin CN.nr.62/17 datë 23.07.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I.MIRATOHET, në tërësi si e bazuar kërkespadi e paditësit B.H.G., nga fshati N..., Komuna Kaçanik dhe DETYROHET e paditura Republika e Kosovës – Qeveria e Republikës së Kosovës që paditësit të i'a paguaj shumën prej 17.211.00€ në emër të dëmit të pësuar për shkak të shpronësimit edhe ate: për pjesën e mbetur jashtë shpronësimit në anën lindore të ngastrës kadastrale 00421-0, me kulturë arë e klasës 4 dhe 6, në sipërfaqe prej 1644 m² x 14€/m² e në shumë prej 17.211.00€ e cila gjendet në Z. K N....

Poashtu dëmin edhe për pjesën e mbetur jashtë shpronësimit në anën perëndimore të ngastrës kadastrale 00421-0, me kulturë arë e klasës 4 dhe 6, në sipërfaqe prej 2037 m² x 14€/m² = 28,518.00 x 20% ë shumë prej 5.703,00 € e cila gjendet në Z. K N....

Shumën prej 17.211.00€, me kamatë prej 8 % duke filluar nga data 28.03.2017 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive.

II.DETYROHET e paditura që paditësit të i'a paguaj shumën nga pika I e këtij dispozitivi të aktgjykimit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 747€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë...”

Kundër aktgjykimit CN.nr.62/17 datë 23.07.2021, të marrë nga Gjykata Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, në afat ligjor i padituri ka parashtruar ankesë për shkak të: shkeljes esencialë të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që të refuzohet në tërësi si e pabazuar propozimi i paditësit B.H.G.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur paditësi B.H.G., me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që ankesën e palës së paditur ta refuzoi si të pa bazuar, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, CN.nr.62/17 datë 23.07.2021, ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore gjeti se:

- Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi B.H.G., nga fshati N..., Komuna Kaçanik, me datë 28.03.2017, ka parashtruar në Gjykatë Themelore në Ferizaj, Dega në Kaçanik, padi kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës lidhur me kompensimin e dëmit-humbje e vlerës së pasurisë së paluajtshme.

Gjykata e shkallës së parë, e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datë 22.06.2021, dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave, ka marrë Aktgjykim CN.nr.62/17 datë 23.07.2021, me të cilin e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit B.H.G., nga fshati N..., Komuna Kaçanik, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera ka arsyetuar se: *"...Ndërtimi i autostradës në mes të ngastrës ka bërë që kjo ngastër ta humb vlerën e saj sepse sipërfaqja e pronës si tërësi është ndarë në dy pjesë edhe atë : në anën lindore të autostradës ka mbetur e pa shpronësuar prej 1644 m², e cila ka humbur qasjen në rrugë, ka humbur formën dhe madhësinë duke ndryshuar edhe pozitën e saj sepse tani e tutje nga ana perëndimore do të kufizohet me autostradën e cila është me sistem të mbyllur. Kjo pjesë e sipërfaqes ka mbetur e bllokuar pa rrugë dhe mundësinë e shfrytëzimit e ka shumë të kufizuar, sepse vendbanimi i pronarit është në anën e kundërt të autostradës dhe për të shkuar deri te kjo pjesë e mbetur e ngastrës pronari duhet të kaloj disa kilometra gjer te ndonjë mbi kalim i autostradës..."*.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, e po ashtu nuk ekzistojnë as shkeljet e Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket pretendimit ankimor se kemi të bëjmë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, nuk ka ndonjë pretendim konkret në të cilën është thirrur pala ankuese në ankesë, ndërsa nuk ka shkelje për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nga ekspertiza e ekspertit vlerësues B.S., të punuar me datë 25.09.2020, i cili ekspert në ekspertizë ndër të tjera ka konstatuar se vlera e humbur – zhvlerësimi për pjesën e sipërfaqes së pa shpronësuar në anën lindore të ngastrës nr.421-0 në sipërfaqe prej 1644 m² x 14,00 €/m²=23,016,00€ x 50%=11,508,00€, vlera e humbur – zhvlerësimi për pjesën e sipërfaqes së pa shpronësuar në anën perëndimore të ngastrës nr.421-0 në sipërfaqe prej 2037m² x14,00€/m²=28.518,00€x20%=5,703,00 €, vlera përgjithshme për kompensim është në total 17,211,00€.

Se nevojitet të vendoset një kompensim real lidhur me pasurinë e shpronësuar kjo e drejtë konstatohet edhe në praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila në rastin Aka kundër Turqisë - 107/1997/891/1103, ndër të tjera e ka arsyetuar se: *"praktika gjyqësore kërkon që "...baraspesha e drejtë" të sigurohet në mes të kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe të drejtave themelore të personit, prona e të cilit ka qenë e shpronësuar ..."* dhe ka konstatuar se ka shkelje të Nenit 1 të Protokollit 1, ku në nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut ndër të tjera thuhet se *"...Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare..."*.

Në nenin 46 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mënyrë decisive thuhet se *“E drejta e pronës është e garantuar”*.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në këtë çështje drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe kështu Gjykata e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen faktike në këtë çështje juridike, për këto arsye aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Pretendimi ankimor i të paditurës se eksperti nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar se si ka ardhur deri te konstatimi se pjesa e mbetur jashtë shpronësimit ka humbur vlerën prej 20%, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që në raportin e vlerësimit të punuar nga eksperti B.S., ndër të tjera thuhet se: *“...nga ana lindore e Autostradës, ka mbetur e pa shpronësuar sipërfaqja e ngastrës 1644m², e cila ka humbur qasjen në rrugë, e ka humbur formën dhe madhësinë duke ndryshuar pozitën e saj, sepse tani e tutje nga ana perëndimore do të kufizohet me Autostradë e cila është me sistem të mbyllur...nga ana perëndimore e Autostradës,... kjo pjesë e ngastrës ka humbur vlerën e saj, sepse tani nga shiqimi i parë nuk shifet pejsazhi i natyrës, është zvogëluar sipërfaqja e pronës si tërësi, pastaj si faktor tjetër që ka ndikuar në uljen e vlerës së tokës – ngastrës është se me rastin e zhvillimit të komunikacionit në këtë Autostradë, prishet ambienti nga gazërat që lirohen dhe zhurma të shumta që krijohen e vështirësojnë jetën normale në këtë pjesë të pa shpronësuar ... ”*, i cili ekspert është paraqitë në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur në Gjykatë me datë 22.06.2021, mirëpo në të njëjtën seancë nuk është paraqitur përfaqësuesi i palës së paditur.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Sa i përket vendosjes nga gjykata e shkallës së parë lidhur me shpenzimet e procedurës, nuk ka pasur pretendime ankimore.

Prandaj nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në mbështetje te nenit 195 par.1 pika d), të ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.7053/2021 datë 20.05.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Bujar Muzaqi